

AKT THEMELIMI

Sot ne dt. 22/04/2024 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",
Z. ANDI SUBASHI i datelindjes 05-10-1993, i lindur ne Vore, SHQIPERI, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID J30705095A ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 25/05/2023,
i cili me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin "**ANDI EXOTIC JET**" shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezqatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**ANDI EXOTIC JET**" shpk. Shoqëria do ti nenshtrohet legjisllacionit Shqiptar. Shoqëria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria "**ANDI EXOTIC JET**" shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria").

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**ANDI EXOTIC JET**" shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka seline ne adresen:

Bashkia Sarande, Zona Kadastrale 8641, Godina me Numer Pasurie 12/86.

Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Operator turistik, dhenia me qera e jetskive, jetskive makine dhe e kanoneve.

Neni 5
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 10,000 leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortakut i vetem i shoqerise si me poshte :

- Ortaku Themelues: **ANDI SUBASHI** zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 10,000 Leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise.

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar **10,000 Leke.**

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **10,000 Leke**, do te paguhet ne avance nga ne ortakut.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakut pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te tretteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II
ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9 Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga dy administrator te perbashket. Administratoret e shoqerise jane:

Z. ANDI SUBASHI i datelindjes 05-10-1993, i lindur ne Vore, SHQIPERI, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID J30705095A ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 25/05/2023.

Znj. XHULJA MUSA e datelindjes 25-06-1998, e lindur ne Sarande, SHQIPERI, madhore me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID J85625051G ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 21/05/2015

Administratoret emerohen me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, te cilet kane te gjitha kompetencat per te kryer bashkarisht te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi. Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim te Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Neni 10 Kompetencat

Administratoret kane kompetencat si me poshte:

Administratori **Z. ANDI SUBASHI** i cili eshte ortaku i vetem i shoqerise ka te gjitha kompetencat e plota dhe te pakufizuara qe te veproje i vetem,i pavarur ne perputhje me statutin dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per te gjitha veprimet e nevojshme lidhur me aktivitetin ekonomik te shoqerise.

Znj. XHULJA MUSA do te veproj si Administrator i shoqerise dhe do te kete vetem te drejten qe te kryej : Veprimtarine Turistike te Shoqerise, per aktivitetin e lundrimet detar .

Administratoret angazhojne shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratores ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontrahojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzues apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përkrahimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jehet

a. Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimtë të metejshme të veprimtarisë së saj.

b. Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji "Për Falimentimin"

c. Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këto raste Asambleja e Ortakut të vetëm merr vendim me shumicë në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqëri në likuidim të siper ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këto aktet themelimi dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këto aktet themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodin Civil, Ligjin për QKB, dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 14

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në tre ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën italiane dhe pasi miratohet në parim dhe nënper nën nga Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë tregtare "ANDI EXOTIC JET" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.


ORTAKU I VETEM

ANDI SUBASHI

Andi Subashi


ADMINISTRATORET

ANDI SUBASHI

Andi Subashi


XHULJA MUSA

Xhulja Musa
